



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KRUJË

Nr. 184 Akti

Datë 14.11.2013 Regjistrimi

Nr. 184 Vendimi

Datë 15.11.2013 Vendimi

VENDIM

“Për vendosjen e sekuestros preventive”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, e përbërë prej :

GJYQTARE - ENGJËLLUSHE TAHIRI



asistuar nga sekretare gjyqësore Raimonda KOTA sot më datë 15.11.2013 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore kërkesën penale me nr.184 Akti që i përket:

Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë, përfaqësuar nga prokuror Llambi BAKO.

Objekti: Vendosjen e sekuestros preventive mbi objektin një banesë me mur blloqe betony me përmasa 10.4 x 7.6 x 2.6 m e ndodhur në lagjen nr.1 Mustafa Kaçaçi në qytetin e Krujës e ndërtuar pa leje.

Baza Ligjore: Neni 274/1 i K.Pr.Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata pasi:
-administroi provat bashkëngjitur kërkesës,
-dëgjoi prokurorin i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit,
-shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi.

Vëren se :

Prokuroria e Rrethit Krujë në datën 30.09.2013 ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të "Ndërtimit të paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a paragrafi i dytë i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Gentjan Aga. Kjo pasi në datën 27.09.2013 shtetasi Ferik Fera ka bërë kallzim penal duke pretenduar se në tokën e tij në lagjen Mustafa Kaçaçi ose Varosh të qytetit Krujë është duke u ndërtuar një ndërtim pa leje. Nga ana organit të akuzës janë ndërmarrë veprimet përkatëse hetimore si kqyrja e vendit të ngjarjes, kqyrja, marrja dhe sekuestrimi i dokumentave, pyetja e personit nën hetim dhe atyre që kanë dijeni për veprën penale etj. Nga të dhënat e deri tanishme organi i akuzës dyshon se banesa është një ndërtim i paligjshëm dhe për të parandaluar veprime të mëtejshme është e nevojshme vendosja e sekuestros preventive. Për rrjedhojë prokurori kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit.

Nga sa më sipër, bazuar në aket dhe provat e shqyrtuara në seancë **Gjykata** çmon se kërkesa e prokurorisë duhet të pranohet sepse : *Së pari*, njëra nga vepra penale për të cilat ka nisur procedimi penal është ajo e "Ndërtimit të paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a paragrafi i dytë i Kodit Penal. *Së dyti*, personi nën hetim është në pozita pohuese rreth pretendimit të organit të akuzës se ndërtimi është realizuar pa respektuar ligjin për urbanistikën. *Së treti*, ekziston një dyshim i arsyeshëm e i bazuar në prova se sendi është produkt i një vepre penale dhe se disponimi i lirë i tij mund të ndikojë negativisht në veprimet hetimore të organit të akuzës.

Pasur parasysh rrethanat e faktit të konstatuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat e aktet shkresore të administruara në seancë si dhe arsyetimin ligjor të lartpërmendur, Gjykata çmon se kërkesa është e bazuar në ligj e prova,

Për këto arsye


Gjykata bazuar në nenin 274 e vijues të K.Pr.Penale,

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Krujë.
2. Vendosjen e sekuestros preventive për objektin : "banesë me mur blloqe

- betoni me përmasa 10.4 x 7.6 x 2.6 m që ndodhet në lagjen nr.1 Mustafa Kaçaçi qyteti Krujë” e dyshuar se është ndërtuar pa leje.
3. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi.
 4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit ligjor.
 6. U shpall në Krujë më datë 15.11.2013.

Sekretare
Raimonda KOTA



GJYQTARE
Engjëllushe TAHIRI



VERTETOHET
Se vendimi ka marrë formë të prerë
SOT ME DATE 25.11.2013
KANCELARI I GJYKATES
ARGJEND QESJA

